

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË /DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**, me gjyqtarin Arben Hoti, në cilësinë e Kryetarit të Trupit Gjykues, dhe sekretaren juridike Shqipe Rexhepi, në çështjen penale kundër të pandehurit G.S., për shkak të veprës penale: Keqpërdorim i të drejtës së votimit nga neni 216 par 1 pika 1.2 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.Nr.513/2014 të dt.18.11.2014, pas shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 27.04.2018, në të cilën ishin të pranishëm Prokurori i Shtetit – Ilaz Beqiri, dhe i pandehuri G.S., në vështrim të nenit 365 të KPPRK-së, gjykata të njëjtën datë mori dhe publikisht shpalli këtë:

### AKTGJYKIM

**I pandehuri: G.S.**, i biri i Z. dhe S., e gjinisë Z., i lindur me dt ..., i lindur në P., me vendbanim në fshatin P., KK O., i martuar, baba i ... fëmije, i pa punë, me profesion j., i gjendjes së varfër ekonomike, me numër personal ... i lëshuar nga MPB- RKS, Serb, shtetas i Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

**Sepse:** Me dt. 03.11.2013 në shkollën fillore “D.O.” që gjendet në fshatin P., KK O., i pandehuri ka keqpërdorur të drejtën e votimit, gjatë procesit të votimeve për pushtetin lokal, në atë mënyrë që edhe pse ka votuar si votues i rregullt, ka votuar edhe si votues me kusht, sipas zarrfit të fletëvotimeve me kusht në numrin e vendvotimit ....

- Me këtë ka kryer veprën penale: Keqpërdorim i të drejtës së votimit nga neni 216 par 1 pika 1.2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata bazuar në nenin e lartpërmendur dhe nenet 7,17,21,41,43,49,50,51,52,73 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPRK –së, i shqipton:

### DËNIM ME KUSHT

Të pandehurit **G.S.**, i caktohet dënim burgimi në kohëzgjatje prej **8 (tete) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në rast se i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale, në periudhën prej **1 (një) viti**.

Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë paushallin gjyqësor në shumën prej 30 euro, në afatin prej 30 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka ngritur aktakuzë PP.Nr. 513/2014 të dt. 18.11.2014, me të cilën e ka akuzuar të pandehurin G.S., për shkak të veprës penale Keqpërdorim i të drejtës së votimit nga neni 216 par 1 pika 1.2 të KPRK-së.

Me datë 27.04.2018, Gjykata Themelore në Prishtinë ka caktuar dhe mbajtur seancën fillestare në këtë çështje penale, në të cilën ishin prezent prokurori i shtetit – Ilaz Beqiri dhe i pandehuri G.S., ku prokurori i Shtetit ka lexuar akuzën, ndërsa Kryetari i Trupit Gjykses pasi që u bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, të njëjtit i dha mundësinë konform nenit 246 par.4 të pranojë fajësinë ose të deklarohej i pafajshëm.

I pandehuri G.S., mes tjerash ka deklaruar: se e ka kuptuar aktakuzën nuk ka pasur nevojë për sqarime shpesh, dhe ka pranuar fajësinë për veprën penale që i vihej në barre. Duke shtuar se është përdorur për veprimet e marrura, ka vepruar me mendjelehtësi, gjithashtu i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra penale.

Prokurori i shtetit-Ilaz Beqiri ka deklaruar pranimit të fajësisë është bërë konform dispozitave ligjore, në përputhje me provat e propozuara nga prokuroria, duke i propozuar gjykatës që një pranim të tillë ta aprovojë. Prokurori i shtetit i propozojë gjykatës që me rastin e matjes së dënimit të merret si rrethane lehtësuese pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit në fazën fillestare.

Megjithatë i pandehuri e ka pranuar fajësinë gjykata ka konstatuar se janë plotësuar kriteret nga neni 248 par. 1 të KPPK-së, dhe i pandehuri ka pranuar vullnetarisht fajësinë, ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë. Pranimi mbështetet në provat dhe faktet që përmban akuza, siç janë: lista me të dhënat e votuesve, kopja e zarfit të fletëvotimit me kusht për numër ..., kopja e listës përfundimtare të votuesve, foto albumi, si dhe shkresat tjera të lëndës.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat e parapara sipas nenit 73 të KPRK-së që ndikojnë në matjen e dënimit, ku si rrethanave çanërisht lehtësuese për të pandehurin mori pranimit të fajësisë nga i pandehuri, pendimin e thellë të shprehur nga ana e të pandehurit, gjendjen e dobët ekonomike të tij, sjelljen e tij korrekte në gjykatore, si dhe moshën e thyer, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti. Gjykata të pandehurit i shqiptoi dënim burgimi me kusht si në pjesën dënuese të këtij aktgjykimi, duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi ndëshkimor, në kuptim të preventivës individuale, që të parandaloj të pandehurin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës gjenerale që të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u mor komform nenit 450 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos sikursenë dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**PKR 665/14, datë 27.04.2018**

**Sekretarja Juridike:**  
**Shqipe Rexhepi**

**Gjyqtari:**  
**Arben Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, prej momentit të marrjes së këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.